
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A

Data 17.07.2026

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE, NDARË NË 2 (DY) LOTE:

LOTI 1 -FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE DIESEL (GAZOIL 10 PPM)

LOTI 2 - FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE (BENZINË PA PLUMB)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) :

Karburante 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit: “Furnizim me lëndë djegëse” me fond limit të përgjithshëm 111,687,122.44 (njëqind e njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e dy pikë dyzet e katër) lekë pa TVSH ose 1,193,493.51 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e një) euro pa TVSH, ndarë në 2 (dy) lote:

Loti 1 -“Furnizim me lëndë djegëse, Gazoil 10 ppm” me fond limit: 91,679,345.44 (nëntëdhjetë e një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dyzet e pesë pikë dyzet e katër) lekë pa TVSH ose 979,689.52 (nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e dy) euro pa TVSH.

Loti 2 - “Furnizim me lëndë djegëse, Benzinë pa plumb” me fond limit 20,007,777 (njëzet milion e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 213,803.99 (dyqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e tre pikë nëntëdhjetë e nëntë) euro pa TVSH.

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 17/ 07/2026 është 93.58 (nëntëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e tetë) euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

Të njëjta për të dyja Lotet

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Loti 1 : “Furnizim me lëndë djegëse, Gazoil 10 ppm”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin

Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licencën përkatëse për tregtimin me shumicë të karburantit, objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, 5) *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknikedhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në kushtet kur kemi të bëjmë edhe me furnizim me bot, furnizim i cili ofrohet nga shoqëritë e tregtimit me shumicë. Në procedurën e prokurimit me objekt: Loti 1-“Furnizim me lëndë djegëse, Gazoil 10 ppm” është përfshirë kërkesa e (një) autoriteti kontraktor përfituese ku është përcaktuar si mënyrë levrimi të lëndës djegëse Gazoil 10 ppm furnizimi me anë të botit sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor Përfitues, Dega e Doganes Pogradec.Ndodhur në këto kushte AK është i detyruar të kërkojë paraqitjen e licencës së tregtimit me shumicë të operatorëve ekonomikë pjesmarrës me qellim garantimin e përmbushjes me sukses të kontratës.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku citohet: Neni 77/pika 3: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar

kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. Neni 43/pika 2/germa : Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme . Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) **dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbikufirin e lartë monetar**; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve për vitet ushtrimore (2023, 2024,2025) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 (të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”*, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore*

së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurren. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e karburanteve në pronësi ose me qera ku minimumi duhet të ketë stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve:

- në Bashkinë Tiranë të ketë të paktën 3 (tre) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve sipas tabelës nr.1;
- në Bashkitë/Njësitë Administrative të ketë të paktën 3 (tre) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve sipas tabelës nr 2;
- në akset rrugore kryesore të ketë të paktën 3 (tre) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve sipas tabelës nr 3 ;

Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas tabelës së mëposhtme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Tiranë Qendër (Unaza e Vogël)		
2	Përgjatë Rrugës së Kavajës		
3	Përgjatë Rrugës së Durrësit		

Tabela nr. 2 orientuese:

Nr	Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja(adresa)	Person kontakti
1	Gjirokastrë		
2	Pogradec		
3	Vlorë		

Tabela nr.3 orientuese

Nr	Akset rrugore kryesore	Vendodhja(adresa)	Person kontakti
1	Tiranë-Gjirokastrë		
2	Tiranë-Pogradec		
3	Tiranë-Vlorë		

*Etj- Nënkupton të gjitha stacionet të shitjes së karburanteve me pakicë të tjera të cilat operatori ekonomik i disponon (në pronësi ose me qera).

*Shënim 3.1:

Ne zbatim të Kodit Civil operatorët ekonomik të disponojnë stacione të shitjes së karburanteve me pakicë si më poshtë:

-Ne pronësi dhe/ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB;

-Kontrate noteriale qeraje ose furnizimi;

*Shenim 3.2:

Për të gjitha stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve duhet te paraqitet dokumentacioni si me poshte:

- Licencë leshuar nga pushteti vendor per tregtim karburantesh me pakice;
- Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK)
- Certifikate e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, të ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës , intineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë si dhe shtrirjes gjeografike të ushtrimit të veprimtarisë së AK-ve . Në këtë procedurë prokurimi marrin pjesë disa autoritete kontraktore si p.sh Garda e Republikës , Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë , Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë, Drejtoria e Rajonit Verior Shkoder (ARRSH) , Agjencia e Ekzekutimit te Vendimeve Penale, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë të cilat e ushtrojnë aktivitetin e tyre jo vetëm në Tiranë por në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në vendosjen e një numri minimal prej 3 stacionesh tregtimi me pakice te karburanteve në Bashkinë e Tiranës është marrë parasysh madhësia e territorit të kësaj bashkie, si bashkia më e madhe në vend dhe numri i autoriteteve që e kane seline dhe operojnë kryesisht në kete bashki.Në vendosjen e një numri minimal prej 3 stacionesh tregtimi me pakice te karburanteve në akset kryesore ndërlihdhëse të vendit dhe minimalisht 3 të tilla në bashkitë/njësitë administrative është marrë parasysh mbulimi me shërbim të ofrimit të karburantit me efijencë dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, qe jane pjese e kesaj procedure, duke patur parasysh shtrirjen e tyre gjeografike dhe territorin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Gjithashtu sjellim në vemendje se pothuajse të gjitha autoritetet pjesemarrëse ne tender e ushtrojne veprimtarine e tyre edhe jashte bashkive ku kane selite perkatese, duke sjelle nevojën e pashmangshme per akses ne furnizim ne akset kryesore te vendit.

Dokumentacioni për stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve eshte kerkuar sipas parashikimit te pikes II “Procedura për dhënien e licencave për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, i ndryshuar me ane te se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale si dhe dokumentacionin shoqërues, për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, ne kushtet kur kemi te bëjmë me furnizim me kartë elektronike, sipas kërkesës

së disa Autoriteteve Kontraktore, konkretisht 7 (shtatë) autoritete kontraktore (referuar shtojcës 7 për lotin 1 "Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit").

Theksojmë se të gjitha Bashkitë/Njësitë Administrative të caktuara në Tabelën 1, 2 dhe 3 të këtij kriteri janë orientuese. Per sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë flete analiza të lëshuar nga ISHTI (për ato zëra të cilat është i akredituar), brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës sipas standarteve në fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar ku citohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose; b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose; **c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.** Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për testime/rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar nga AK brenda brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës sipas standarteve në fuqi;

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesisë brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", te ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar ku citohet se: Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon, që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmblotje kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit nëfuqi; c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete për një periudhë kohore prej brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targonë e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepermjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.
- Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (ëeb page), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nepermjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targonë e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukture piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar levizjen e mundshme të targave nga mjetet shtetërorë drejt mjeteve private.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara me sipër në menyre elektronike nepermjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (ëebpage), që ofron cdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për s’kualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në pikën 1 të VKM Nr.561, datë 29.7.2016 Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të Karburantit në Njësitë E Qeverisjes së Përgjithshme” 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nepermjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj. Karta elektronike përfshin identifikimin e mjetit, kontrollin e sasisë dhe gjurmueshmërinë e furnizimit të mjetit. Identifikimin e mjetit dhe transparencës së lëvrimit të sasisë të karburantit. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci për AK se furnizimi do të realizohet me karta elektronike sipas kërkesave të parashikuara me lart. Të gjitha pikat e parashikuara me lart ofrohen nga faqja e menaxhimit të karburantit nepermjet të

cilit Autoritetet Kontraktore përfituese menaxhojnë shpërndarjen dhe informohen në cdo kohë me lëvizjet që kryhen me sasine e karburantit të prokuruar. Faqja e menaxhimit të karburantit vihet në dispozicion të Autoritetit Kontraktor menjëherë pas lidhjes së kontratës dhe nëpërmjet kësaj faqe Autoriteti menaxhon sasine e karburantit nga lidhje e kontratës/marrëveshjes kuadër deri në përfundimin e tyre duke garantuar transparencë totale në menaxhimit e sasive dhe shpërndarjes së karburantit . Vendosja e këtij kriteri është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim teknik të leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Leje mjedisore përkatëse, të leshuar nga QKL, Akt-Teknik të leshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi të leshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregtimit që vërteton kapacitetet depozituese lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoriteteve kontraktore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitete teknike me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses dhe për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Dokumentacioni i sipërpermendur është kërkuar sipas parashikimit të pikes III “*Kushtet për pajisjen me licencë të tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, me anë të se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë dokumentacionin përkatës. *Vërtetimi teknik i leshuar nga OMVK* siguron që infrastruktura dhe depozitat janë në përputhje me standardet teknike dhe normat e sigurisë, duke minimizuar rrezikun e defekteve apo incidenteve gjatë operimit; *Leja mjedisore* garanton që aktiviteti i depozitimit dhe tregtimit zhvillohet në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, duke parandaluar ndikime negative dhe duke respektuar kuadrin ligjor përkatës; *Akti teknik nga PMNZH* është thelbësor për të vërtetuar që objektet përmbushin standardet e mbrojtjes nga zjarri dhe emergjencat, duke qenë se aktivitetet me depozita paraqesin rrezik të shtuar; *Polica e sigurimit* siguron mbulim financiar ndaj rreziqeve të mundshme që lidhen me aktivitetin, duke mbrojtur si autoritetin kontraktor ashtu edhe palët e treta nga pasojat e mundshme të incidenteve; *Kapacitet depozitimi* siguron që operatori ekonomik ka mundësi të përballojë kërkesat e autoritetit kontraktor edhe në raste të ndërprerjeve të furnizimit apo luhatjeve të tregut si dhe për të garantuar realizimin e kontratës në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën. Me anë të këtij kriteri AK synon të sigurojë cilësi, siguri dhe vazhdimësi në furnizim për të gjitha Autoritetet Kontraktore përfituese pjesë e Lotit 1, të Dokumentave Standarte të Tenderit.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) autobot/ autocisternë me kapacitet mbajtës minimalisht 5 000 litra, të cilin mund ta ketë në pronësi/qira/përdorim.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqesë nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Shënim:

Per mjetet me status pronësi/qira/përdorim te disponohet kontrata perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, certifikaten per transportin e lendeve te rrezikshme dhe pashaporten e mjetit perkapacitetin mbajtes ne litra.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

1.Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar ku citohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknikedhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a)licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose; b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/osekomponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose; c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ; ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor përfitues, Drejtoria e Doganës Pogradec , ka kërkuar furnizim me lëndë djegëse Gazoil 10 ppm me bot, sipas sasisë së përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit. Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar besim se operatori ekonomik fitues do të përmbushi me sukses këtë kontratë.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te paraqese deklarate ne baze te se ciles merr persiper furnizimin me lëndë djegëse me autobotin/ autocisternën e tij dhe shpenzimet e tij deri ne vendin ku ndodhen depozitat e autoritetit kontraktor perfitues duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore për transportin e lëndeve djegëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”, te ndryshuar, me ane te se cilit operatori ekonomik

vetedeklaron duke ofruar garanci per AK se furnizimi do te realizohet me bot sipas kerkesave te parashikuara me lart. (referuar shtojcës 7 për lotin 1 "Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit").

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti 2 : “Furnizim me lëndë djegëse, Benzinë pa plumb”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë*

arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku citohet: Neni 77/pika 3: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. Neni 43/pika 2/germa : Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme . Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) **dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbikufirin e lartë monetar;** b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve për vitet ushtrimore (2023, 2024,2025) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 (të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar

kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e karburanteve në pronësi ose me qera ku minimumi duhet të ketë stacion të tregtimit me pakice të karburanteve:

- në Bashkinë Tiranë të ketë të paktën 2 (dy) stacione të tregtimit me pakice të karburanteve sipas Tabelës nr.1;
- në Bashkitë/Njësitë Administrative sipas tabelës nr 2 të ketë të paktën 2 (dy) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve
- në akset rrugore kryesore sipas tabelës nr 3 të ketë të paktën 2 (dy) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve

Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice sipas tabelës mëposhtme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Tiranë Qendër (Unaza e Vogël)		
2	Përgjatë Rrugës së Kavajës		

Tabela nr. 2 orientuese:

Nr	Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja(adresa)	Person kontakti
1	Gjirokastrë		
2	Vlorë		

Tabela nr.3 orientuese

Nr	Akset rrugore kryesore	Vendodhja(adresa)	Person kontakti
1	Tiranë - Gjirokastrë		
2	Tiranë-Vlorë		

*Etj- Nënkupton të gjitha stacionet të shitjes së karburanteve me pakicë të tjera të cilat operatori ekonomik i disponon (në pronësi ose me qera).

Shenim 3.1:

Ne zbatim të Kodit Civil operatorët ekonomik të disponojnë stacione të shitjes së karburanteve me pakice si më poshtë:

- Ne pronësi dhe/ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB;
- Kontrate noteriale qeraje ose furnizimi;

Shenim 3.2:

Për të gjitha stacionet e tregtimit me pakice të karburanteve duhet të paraqitet dokumentacioni si me poshte:

- Licence leshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakice;
- Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, të ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës, itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë si dhe shtrirjes gjeografike të ushtrimit të veprimtarisë së AK-ve. Në këtë procedurë prokurimi marrin pjesë disa autoritete kontraktore si p.sh Garda e Republikës, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë, Drejtoria e Rajonit Verior Shkoder (ARRSH), Agjencia e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë të cilat e ushtrojnë aktivitetin e tyre jo vetëm në Tiranë por në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në vendosjen e një numri minimal prej 3 stacionesh tregtimi me pakice të karburanteve në Bashkinë e Tiranës është marrë parasysh madhësia e territorit të kësaj bashkie, si bashkia më e madhe në vend dhe numri i autoriteteve që e kanë seline dhe operojnë kryesisht në këtë bashki. Në vendosjen e një numri minimal prej 3 stacionesh tregtimi me pakice të karburanteve në akset kryesore ndërlidhëse të vendit dhe minimalisht 3 të tilla në bashkitë/njësitë administrative është marrë parasysh mbulimi me shërbim të ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, që janë pjesë e kësaj procedure, duke patur parasysh shtrirjen e tyre gjeografike dhe territorin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Gjithashtu sjellim në vëmendje se pothuajse të gjitha autoritetet pjesëmarrëse në tender e ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe jashtë bashkive ku kanë selite perkatese, duke sjelle nevojën e pashmangshme për akses në furnizim në akset kryesore të vendit.

Dokumentacioni për stacionet e tregtimit me pakice të karburanteve është kërkuar sipas parashikimit të pikes II “Procedura për dhënien e licencave për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, i ndryshuar me ane të se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale si dhe dokumentacionin shoqëruar, për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në kushtet kur kemi të bëjmë me furnizim me kartë elektronike, sipas kërkesës së disa Autoriteteve Kontraktore, konkretisht 5 (pesë) autoritete kontraktore (referuar shtojcës 7 për lotin 2 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”).

Theksojmë se të gjitha Bashkitë/Njësitë Administrative të caktuara në Tabelën 1, 2 dhe 3 të këtij kriteri janë orientuese. Per sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë flete analiza të lëshuar nga ISHTI (për ato zëra të cilat është i akredituar), brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës sipas standarteve në fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar ku citohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose; b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose; **c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.** Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për testime/rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar nga AK brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës sipas standarteve në fuqi;

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesive brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar ku citohet se: Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon, që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social

dhe të punës; ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete për një periudhë kohore brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targonë e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepermjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (ëeb page), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targonë e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukture piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar levizjen e mundshme të targave nga mjetet shtetërorë drejt mjeteve private.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara me sipër në mënyrë elektronike nepermjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron cdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për s’kualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në pikën 1 të VKM Nr.561, datë 29.7.2016 Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të Karburantit në Njësitë E Qeverisjes së Përgjithshme” 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj. Karta elektronike përfshin identifikimin e mjetit, kontrollin e sasisë dhe gjurmueshmerinë e furnizimit të mjetit. Identifikimin e mjetit dhe transparencës së lëvritimit të sasive të karburantit. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci për AK se furnizimi do të realizohet me karta elektronike sipas kërkesave të parashikuara më lart. Të gjitha pikat e parashikuara më lart ofrohen nga faqja e menaxhimit të karburantit nëpërmjet të cilit Autoritetet Kontraktore përfituese menaxhojnë shpërndarjen dhe informohen në cdo kohë me lëvizjet që kryhen

me sasine e karburantit te prokuruar. Faqja e menaxhimit të karburantit vihet në dispozicion te Autoritetit Kontraktor që me lidhjen e kontratës dhe nëpërmjet kësaj faqe Autoriteti menaxhon sasine e karburantit nga lidhje e kontratës/marrëveshjes kuadër deri në përfundimin e tyre duke garantuar transparencë totale në menaxhimit e sasive dhe shpërndarjes së karburantit . Vendosja e këtij kriteri është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Loti 1: “Furnizim me lëndë djegëse diesel (Gazoil 10 ppm)”

Gazoil 10 ppm ULSD duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 590:2025 ose ekuivalent, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Loti 2: “Furnizim me lëndë djegëse për automjete benzine pa plumb”

Benzina (Premium Unl 10 ppm) duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 228 : 2025 ose ekuivalent, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Shënim: Për çdo standart ose emërtim marke të përmendur pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupet e punës të ngritur nga Titullarët e Autoriteteve Kontraktore përfituese, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

NJËSIA E PROKURIMIT